



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVISIONI KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Njësia e Auditimit të brendshëm
Jedinica za unutrašnju reviziju
Internal Audit Unit

DRAFT RAPORTI

***PAGESAT PËR ORËT SHITESË TË PUNËTORËVE TË
RADIOTELEVISIONIT TË KOSOVËS GJATË VITIT 2023 DHE MUAJVE
JANAR DHE SHKURT 2024***

Maj 2024

BAZUAR NË PLANIN VJETOR

*Auditimi Nr. 01, bazuar në
planin vjetor 2024*

DEPARTAMENTI I AUDITUAR :

*Administrata, Drejtorit të
Përgjithshëm*

LLOJI I AUDITIMIT :

*Sistemet/pajtueshmëria/fina
nciare*

KOHËZGJATJA E AUDITIMIT :

Prill – Maj 2024

Udhëheqësi/e i Njësisë së Auditimit të Brendshëm:

Nevruz Oruqi

Antare e Ekipit të Auditimit:

Lozartë Duraku

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJA E PËRGJITHSHME.....	5
1. HYRJA.....	7
2. QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT.....	8
2.1 Objektivat e auditimit	
2.2 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	
3. REZULTATET.....	10
❖ Çështjet (të gjeturat)	
❖ Kriteri	
❖ Gjendja	
❖ Shkaku	
❖ Ndikimi	
❖ Konkluzionet	
❖ Rekomandimet	
4. REKOMANDIMET.....	15
5. ANEKS I -TË GJETURAT E RAPORTIT TË AUDITIMIT DHE KOMENTET E TË AUDITUARIT.....	16
6. ANEKS II- PLANI I VEPRIMIT TË MENAXHMENTIT.....	18

SHKURTESAT

AB	<i>Auditimi i brendshëm</i>
Bordi	<i>Bordi i RTK</i>
DF	<i>Departamenti i Financave</i>
KA	<i>Komiteti i Auditimit</i>
NjAB	<i>Njësia e Auditimit të brendshëm</i>
RTK	<i>Radiotelevizioni i Kosovës</i>
RrAB	<i>Rregullore për Auditimin e brendshëm</i>
SNPPAB	<i>Standardet Ndërkombëtare për Praktikë profesionale në Auditimin e brendshëm</i>
ZKA	<i>Zyrtari Kryesor Administrativ</i>
ZKF	<i>Zyrtari Kryesor Financiar</i>

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Në pajtueshmëri me Planin e aprovuar të Auditimit të Brendshëm për vitin 2024, nga Bordi i RTK-së, Njësia e Auditimit të brendshëm ka përfunduar auditimin “Pagesat për orët shtesë të punëtorëve të Radiotelevizionit të Kosovës gjatë vitit 2023 dhe muajve janar dhe shkurt 2024 “. Qëllimi i këtij auditimi është vlerësimi i pajtueshmërisë me Ligjet dhe aktet tjera nënligjore, të zbatueshme në Kosovë, si dhe ekzaminimin e zbatimit në praktikë të mekanizmave të vendosura të kontrollit të brendshëm.

Objektivat e këtij auditimi përfshijnë: Të sigurojë që pagesat janë kryer në përputhje me politikat dhe procedurat e vendosura, duke përfshirë vlerësimin e saktë të numrit të orëve të punës dhe përcaktimin e pagave për secilën kategori të punëtorëve sipas kontratave të tyre.

Të verifikojë përputhjen e pagesave të orëve shtesë të punëtorëve me dokumentacionin mbështetës. Kjo pjesë e auditimit do të sigurojë që çdo pagesë është e mbështetur në informacionin korrekt dhe të dokumentuar për numrin e orëve të punës, duke identifikuar dhe korigjuar çdo mospërputhje ose anomali që mund të dalin gjatë procesit të verifikimit.

Duke marrë parasysh shqetësimet e Drejtorit të Përgjithshëm lidhur me pagesat e orëve shtesë të stafit, bordi ka aprovuar kërkesën dhe ka udhëzuar NjAB-in që të fillojë auditimin specifik. Njësia e Auditimit të Brendshëm ka vlerësuar dhe ka bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e këtij aktiviteti auditimi, në mënyrë që të sigurohet menaxhmenti dhe bordi se sistemi i kontrollit të brendshëm lidhur me menaxhimin e pagesave për orët shtesë funksionon në mënyrë efektive dhe në përputhje me rregullativen ligjore dhe nënligjore.

Në vijim, NjAB shpalos çështjet kryesore të auditimit si:

- Tejkalimi i orëve shtesë mbi normën e lejuar ligjore,
- Dublifikimi i dosjeve të punës jashtë orarit,
- Mos identifikimi real i kohës dhe orëve nga moduli i qasjes së sistemit kohë pas kohe,
- Mungesa e autorizimeve dhe dokumentacionit të mjaftueshëm mbështetës për pagesat e orëve shtesë të punëtorëve.
- Mos publikimi i orarit të punës në hapësirat e dukshme në objektet e RTK-së, dhe

Konkluzionet e përmbledhura - Gjatë auditimit është vërejtur se ka pasur tejkalime të orëve shtesë në RTK, të cilat mund të shkaktojnë shpenzime të paligjshme. Gjithashtu, është konstatuar se ka dublikim të dokumentacionit për dosjet e orëve shtesë, duke rezultuar në mungesë kontrolli të brendshëm që mund të sjellë pagesa të dyfishta për të njëjtat orë shtesë. Sistemi i hyrje-daljeve është jofunksional kohë pas kohe, duke sjellë vështirësi në kalkulimin e orëve të stafit. Po ashtu, është vërejtur se në hyrjet kryesore të dy objekteve nuk është vendosur orari i punës në hapësirat e dukshme siç kërkohet me aktet ligjore në fuqi. Mos publikimi i tillë lidhur me orarin e punës të stafit të RTK-së mund të ndikojë në ankesa dhe paqartësi të ndryshme. Ndërhyrje urgjente është e nevojshme për përmirësimin e monitorimit dhe dokumentimit të orëve shtesë në përputhje me politikat dhe rregulloret.

Rekomandimet tona, të cilat janë paraqitur në hollësi në pjesën 3 të këtij Raporti, janë përmbledhur si më poshtë:

Me qëllim të përmirësimit, rekomandojmë, që:

- Rekomandohet që menaxhmenti të sigurojë mbulimin e orëve shtesë me staf të mjaftueshëm.
- Rekomandohet që menaxhmenti të ndërmarrë masat e nevojshme për përmirësimin e sistemeve të kontrollit, duke eliminuar dublifikimin e dokumenteve për orët shtesë.
- Rekomandohet që menaxhmenti të eliminojë defektet e modulit të qasjes në sistemin e hyrjeve dhe daljeve.
- Rekomandohet që administrata e RTK-së të publikojë orarin e punës në hapësirat e dukshme.
- Rekomandohet implementimi i një sistemi të qartë dhe të përshtatshëm për autorizimin dhe dokumentimin e orëve shtesë të punës.
- Rekomandohet që menaxhmenti të sigurojë që Master Room-it të jetë gjithmonë i mbuluar me dy persona gjatë ndërrimeve të natës, duke marrë parasysh rëndësinë jetike.
- Rekomandohet që menaxhmenti të lejojë pagesën e orëve shtesë brenda kornizave të lejuara ligjore, të cilat vlerësohen të nevojshme.

1. HYRJE

Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) është person juridik, joprofitabil me status të institucionit të pavarur publik, me rëndësi të posaçme kulturore dhe kombëtare, i cili ofron shërbim publik në fushën e veprimtarisë mediale, të përcaktuar me Ligjin e RTK-së Nr.04/L-046 dhe aktet e tjera përkatëse ligjore dhe nënligjore.

Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) ka mision informues, edukues, kulturor dhe argëtues.

Radiotelevizioni i Kosovës, me Rregulloret mbi organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës, ka përcaktuar ndarjen e saj në dikasterë përkatëse siç janë: Drejtori, Departamente dhe Njësi organizative, të cilave u janë përcaktuar edhe linjat e raportimit si dhe përshkrimet e vendeve të punës për çdo pozicion.

Aktiviteti i Njësisë së Auditimit të Brendshëm ka për qëllim t'i ndihmojë RTK-së:

- për të qenë llogaridhënëse ndaj publikut, duke matur zbatimin e ligjit, rregulloreve dhe kontrolleve të vendosura, si dhe efektivitetin, ekonomizimin dhe efikasitetin e veprimeve;
- në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të tyre duke përmirësuar sistemet dhe shërbimet;
- në mbrojtjen e pasurive, duke parandaluar mashtrimin, humbjen dhe keqpërdorimin; si dhe
- mund t'u ndihmoj punonjësve në përmirësimin e performancës së përgjithshme të punës dhe në zbatimin e kontrolleve të vendosura.

Për realizimin e këtij auditimi janë zhvilluar aktivitete, nëpër hapa siç janë:

- Planifikimi i auditimit;
- Përcaktimi i fushëveprimit dhe objektivave të auditimit;
- Përcaktimi i metodave dhe teknikave të auditimit;
- Grumbullimi i dokumentacioneve/materialeve të cilat do i nënshtrohen procedurave të testimit;
- Ekzaminimi (aplikimi i testeve, intervistave, pyetësorëve, verifikimi fizik, ri-shikimi, ri-llogaritjet etj);
- Nxjerrja e rezultateve nga procesi i ekzaminimit dhe vlerësimeve;
- Draft-raporti në dispozicion për komentet e menaxhmentit;
- Raporti Final;

2. QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT

Qëllimi i këtij auditimi, është që të fokusohet në ekzaminimin dhe testimin e kontrolleve të brendshme, që kanë për qëllim adresimin e rreziqeve si: mosidentifikimi i dobësive, jobesueshmëria e të dhënave, rreziku nga dëmtimet dhe shkatrrimet fizike, mospërbushja e objektivave, etj.

2.1. Objektivat e auditimit

Objektiva kryesore për këtë auditim është që t'i ofrojë menaxhmentit që e ka autorizuar auditimin, informata të dobishme, një vlerësim të pavarur dhe siguri të besueshme për cilësinë e mekanizmave të kontrollit të brendshëm, zbatimin e parimeve të qeverisjes së mirë dhe vlerësimin e rrezikut.

Objektivat kryesore të këtij auditimi janë:

Për tu siguruar se:

- Të sigurojë se pagesat janë kryer në përputhje me politikat dhe procedurat e vendosura, duke përfshirë vlerësimin e saktë të numrit të orëve të punësuar dhe përcaktimin e pagave për secilën kategori të punëtorëve sipas kontratave të tyre.
- Të verifikojë përputhjen e pagesave të orëve shtesë të punëtorëve me dokumentacionin mbështetës. Kjo pjesë e auditimit do të sigurojë që çdo pagesë e dhënë është e mbështetur në informacionin korrekt dhe të dokumentuar për numrin e orëve të punësuar, duke identifikuar dhe korrigjuar çdo moszgjatje ose anomalitë që mund të dalin gjatë procesit të verifikimit.

Rreziqet potenciale që mund të ndërlikojnë realizimin e objektivave janë:

- Moszgjatjet në Regjistrimet e Kohës së Përgjithshme të Punës (KPP):
- Mungesa e Autorizimeve për Orët Shtesë të Punës
- Mungesa e Dokumentacionit të Përshtatshëm Mbështetës:
- Mosrespektimi i Politikave dhe Rregulloreve të Pagesave:

2.2. Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Njësia e Auditimit të Brendshëm, më 04.04.2024, ka njoftuar Departamenti e Administrates, se në pajtueshmëri me kërkesën e aprovuar nga bordi i RTK-së për vitin 2024, Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) është në fazën e përgatitjes për të kryer auditimin "Auditimi: Pagesat për orët shtesë të punëtorëve të Radiotelevizionit të Kosovës gjatë vitit 2023 dhe muajve janar dhe shkurt 2024".

Fokusi i auditimit ka qenë i përqendruar në katër sektorë/njësi (Departamenti i Master Room-it, Teknikës, Autoparkut dhe Produksionit). Pas planifikimit dhe koordinimit me auditoren, kemi realizuar takimin fillestar me personat përkatës të njësive, ku kemi trajtuar objektivat dhe qëllimin e auditimit dhe jemi pajtuar që komunikimi dhe plotësimi i mostrave të bëhet në mënyrë elektronike, përmes punës në terren dhe intervistave. Më pas, është kërkuar lista e personave që kanë punuar orët shtesë gjatë muajve janar 2023 deri në shkurt 2024.

Pas pranimit të kësaj liste, nga gjithsej 166 persona të cilët janë angazhuar për orë shtesë gjatë periudhës së audituar 01 janar 2023 - 29 shkurt 2024, është konstatuar se për këtë periudhë janë shpenzuar gjithsej 77,024.97 euro.

Përqindja e testuar e mostrës së ekzaminuar është rreth 28.31%. Për secilin muaj të përfshirë në periudhën e auditimit prej 14 muajsh është kërkuar vijueshmëria, dëftesat e pagave, aprovimet e orëve shtesë dhe propozimet për angazhim për orët shtesë. Kjo nënkupton se në kuadër të kësaj përqindjeje të mostrës janë testuar gjithsej 2,632 dokumente.

Metodologjia e përdorur nga NjAB për përzgjedhjen e lëndëve për ekzaminim është bazuar në mostrim sipas materialitetit dhe gjykimit profesional, në mënyrë që të ofrohet një vlerësim analitik mbi performancën e kontroleve të brendshme. Qëllimi i përzgjedhjes së kësaj mostre është që e njëjta të jetë përfaqësuese dhe gjithëpërfshirëse, për të ofruar një siguri të besueshme se sistemet e vendosura të kontrollit të brendshëm janë efektive.

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka kryer procedurat e auditimit të përcaktuara për të vlerësuar përshtatshmërinë, efikasitetin dhe efektivitetin e parimeve të qeverisjes, menaxhimit të rrezikut dhe proceseve të kontrollit të brendshëm.

3. REZULTATET

Çështja 1.

Gjatë testimit të mostrave, është konstatuar se ka tejkalime të orëve shtesë mbi 32 orë, të cilat nuk janë në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Njëkohësisht, është konstatuar edhe dukuria e bartjes së orëve nga muaji aktual në muajin vijues.

Kriteri :

Bazuar në Ligjin e Punës nr. 03/L-212, neni 23, paragrafi 1: "Në raste të jashtëzakonshme, me rritjen e vëllimit të punëve dhe në raste të tjera të domosdoshme, me kërkesën e punëdhënësit, punëtori duhet të punojë më gjatë se orari i punës (puna jashtë orarit), më së shumti deri në tetë (8) orë në javë."

Gjendja/Kushti :

Në kuadër të ekzaminimit dhe administrimit të mostrave, rreth 70% e mostrave kanë rezultuar me tejkalim të orëve shtesë. Bazuar në analizën krahasuese të periudhave paraprake për dy muaj, kemi një rritje të orëve, e shprehur në vlerë financiare: në janar 2023 krahasuar me janar 2024, kemi një rritje enorme prej 265.14%. Në shkurt 2023 krahasuar me shkurt 2024, rritja është 334.63%.

Po ashtu, është konstatuar një dukuri lidhur me bartjen e orëve nga muaji aktual në muajin vijues tek një pjesë e konsiderueshme e punëtorëve, e cila ka rezultuar në tejkalim të normave të lejuara sipas ligjit. Kjo ka sjellë edhe shpenzime shtesë, siç janë pasqyruar në raport.

Shkaku :

Gjatë diskutimeve dhe intervistave në terren, tejkalimi i orëve shtesë ka rezultuar në mungesë të stafit të mjaftueshëm për mbulimin e orarit të punës, duke ndikuar në funksionimin e rregullt të aktiviteteve të punës.

Ndikimi :

Në kuadër të kësaj, Radio Televizioni i Kosovës i është krijuar kosto shtesë (që nënkupton humbje financiare) lidhur me pagesën e orëve jashtë orarit të punës, në krahasim me mbulimin e orëve të punës me staf të rregullt.

Konkluzion:

Në kuadër të procesit të auditimit dhe gjatë ekzaminimit të mostrave, është vërejtur se ka pasur tekalime të orëve shtesë mbi normën e lejuar ligjore për secilin muaj, të cilat kanë vazhduar me dukuri që kanë rezultuar në shpenzime jashtë përputhjes me ligjin dhe bartje të orëve nga muaji aktual në muajin e ardhshëm.

Bazuar në komunikimet me personat përkatës, kjo situatë ka rezultuar nga mungesa e stafit për mbulimin e plotë të punëve dhe për të përmbushur detyrat e RTK-së. Si rezultat, RTK-së i është krijuar një kosto shtesë që nuk është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.

Rekomandohet që Menaxhmenti të bëjë vlerësimin e nevojave reale për rekrutim, të brendshëm apo të jashtëm të RTK-së, i cili do të mbulonte rrjedhën e aktiviteteve të punës normale jashtë orëve shtesë.

Çështja 2.

Nga ekzaminimet e bëra të mostrave, vërehet se në një rast është zhvilluar një dukuri e vijueshmërisë së orëve shtesë përmes dy dokumente (dosjet e punës jashtë orarit), me nënshkrime ndryshme dhe mospërputhje të orëve në dosjen e punës jashtë orarit me sistemin e vijueshmërisë.

Kriteri :

Bazuar në praktikat e rregullta të RTK-së, për orët shtes dhe formularët për evidentimin e tyre të cilat aplikohen për të gjithë stafin.

Gjendja/Kushti :

Gjatë testimit të mostrave vërehet se në muajin dhjetor 2023 dhe janar 2024 janë dy dosjet e punës jashtë orarit me orë totale të punës të njëjta, në njëren dosje janë konfirmuar orët shtesë nga vetë personi dhe aprovuar nga Drejtori i TV- RTK-së, ndërsa në dosjen tjetër të dublikuar konfirmimi i orëve është bërë nga U.D Udhëheqësi i Produksionit dhe aprovimi nga një person tjetër për Drejtorin e TV- RTK-së i cili nuk ka qenë duke e ushtruar detyrën në atë kohë.

Ndërsa në muajin shkurt 2024 janë dy dosjet e punës jashtë orarit me orë totale të ndryshme të punës dhe mospërputhje të datave, sepse në dosjen e parë janë dy datat 01.02.2024 dhe 21.02.2024 me nga 8 orë jashtë orarit që nënkupton 16 orë ndërsa në dosjen tjetër të pasqyruara datat 07,12,19 dhe 21.02.2024 (që nënkupton janë dy datat të njëjta me kohë të ndryshme të punës, ku dosje e parë e ka 09:00 - 17:00 ndërsa dosje e dytë 08:00 - 16:00) dhe në njëren dosje janë konfirmuar orët shtesë nga vetë personi dhe aprovuar nga Drejtori i TV- RTK-së, ndërsa në dosjen tjetër të dublikuar konfirmimi i orëve është bërë nga U.D Udhëheqësi i Produksionit dhe aprovimi nga një person tjetër për drejtorin e TV- RTK-së.

Po ashtu në kuadër të këtyre tre muajve ka mospërputhje në mes të orëve nga dosjet e punës jashtë orarit me sistemin e vijueshmërisë që nënkupton se orët në dosje janë më të larta se sistemi i vijueshmërisë

Shkaku :

Mosrespektimi i detyrës zyrtare të punës nga persona përkatës ka çuar në dublikimin e dokumenteve të njëjta dhe mungesën e efikasitetit të kontrolleve të brendshme.

Ndikimi :

Nga dublikimi i dokumentave për orët shtesë, rrjedhimisht mund të shkaktohen pagesa dyfishte për RTK-në për punën e njëjtë.

Konkluzion:

Bazuar në kontrollin e dosjeve të punës jashtë orarit të përcaktuar sipas mostrës, është vërejtur se gjatë tre muajve ka pasur dublikime të dokumentacionit për orët e njëjta, të cilat nuk janë administruar me efikasitet dhe nuk kanë pasur aprovimin e duhur. Kjo tregon se sistemi i kontrollit të brendshëm për aprovimin e orëve shtesë ka dështuar, duke rezultuar në nënshkrime të ndryshme në çështjet të njëjta. Kjo situatë mund të shkaktojë pagë të dyfishtë për orët e njëjta.

NjAB rekomandon, që:

Rekomandohet që Menaxhmenti të ndërmarrë masat e nevojshme për të rregulluar çështjet e orëve shtesë përmes ngritjes së sistemeve të kontrollit të brendshme, në mënyrë që të mos përsëriten dukurit e njëjta.

Çështja 3.

Marrë parasysh ekzaminimin e mostrave, vërehet se sistemi i hyrjeve dhe daljeve kohë pas kohe nuk bënë evidentimin real të kalkulimit dhe kohës së hyrjeve/daljeve.

Kriteri :

Në kuadër të politikave dhe sistemit të kontrollit të brendshëm të RTK-së, konkretisht në Sistemin e Kontrollit të Hyrjeve dhe Daljeve të punëtorëve përmes të cilit bëhet menaxhimi i orarit dhe evidentimi i orëve të punës.

Gjendja/Kushti :

Përmes komunikimeve dhe intervistave me personat përkatës, është konstatuar se moduli i sistemit të hyrjeve dhe daljeve kohë pas kohe ka probleme dhe mangësi në evidentimin e kohës reale në momentin e klikimit. Për shembull, nëse një person klikon në orën 22:00 dhe apo në orën 08:00, sistemi nuk llogarit orët reale, por vetëm një pjesë të tyre.

Shkaku :

Sipas intervistave dhe komunikimeve të tjera me departamentet përkatëse, kjo situatë ka vazhduar të ndodhë edhe pas kërkesave për eliminimin e defektit në fjalë.

Ndikimi :

Nga moseliminimi i këtij defekti, nuk kemi një pasqyrë të saktë të orëve të punës për të punësuarit, çka mund të sjellë vështirësi gjatë kalkulimit dhe procesimit të pagave.

Konkluzion:

Në përfundim të ekzaminimit të mostrave, konstatohet se sistemi i hyrjeve dhe daljeve nuk arrin të evidentojë me saktësi kohën dhe kalkulimin e orarit të punës së punonjësve në kohë reale. Sistemi i kontrollit të hyrjeve dhe daljeve të punonjësve, për të menaxhuar orarin dhe evidencën e orëve të punës, shfaq probleme dhe mungesa në identifikimin e saktë të kohës së klikimit. Përmes intervistave dhe komunikimeve me personelin të përfshirë, është evidentuar se kjo problematikë vazhdon edhe pas kërkesave për ta korrigjuar. Mungesa e këtij defekti sjell vështirësi në kalkulimin dhe procesimin e pagave, duke mos ofruar një pasqyrë të saktë të orëve të punës për punonjësit.

NjAB rekomandon, që:

Rekomandohet që Menaxhmenti të udhëzojë personat përgjegjës për eliminimin e defektit të modulit të qasjes së sistemit të hyrjeve dhe daljeve, duke përdorur rregullimin ose furnizimin me një sistem të qasjes së kontrollit.

Çështja 4.

Mungesa e autorizimeve dhe dokumentacionit të mjaftueshëm mbështetës për pagesat e orëve shtesë të punëtorëve.

Kriteri :

Sigurimi i autorizimeve të duhura dhe dokumentacionit të mjaftueshëm mbështetës për pagesat e orëve shtesë të punëtorëve.

Ky kriter është i rëndësishëm për të siguruar që pagesat e orëve shtesë janë të justifikuara dhe të dokumentuara në mënyrë të rregullt dhe transparente, duke parandaluar keqpërdorimin.

Gjendja/Kushti :

Në këtë auditim, u evidentua një mungesë e dokumentacionit të përshtatshëm dhe autorizimeve të dokumentuara për orët shtesë të punës në RTK. Kjo gjendje paraqet një zvarritje dhe mangësi në procesin e pagesave dhe monitorimit të orëve shtesë të punës.

Shkaku :

Shkaku kryesor i kësaj gjendjeje është mungesa e një procedurë të qartë dhe të strukturuar për autorizimin dhe monitorimin e orëve shtesë të punës. Në disa raste, moskryerja e kësaj procedure ndikon në mungesën e dokumentacionit mbështetës dhe krijon një hapësirë për moskorrektime dhe shkelje të rregullave të pagesave.

Ndikimi :

Ky problem ndikon negativisht në transparencën dhe besueshmërinë e procesit të pagesave në RTK. Mosrespektimi i rregullave dhe mungesa e dokumentacionit rritin rrezikun e pasojave ligjore dhe financiare. Përveç kësaj, kjo gjendje mund të ndikojë në moralin dhe motivimin e punonjësve për të angazhuar orë shtesë me besueshmëri.

Konkluzion:

Në përfundim të auditimit, konkludojmë se kjo mungesë e dokumentacionit dhe autorizimeve për orët shtesë të punës është një çështje kritike që duhet të trajtohet menjëherë. Kërkohet një ndërhyrje e menjëhershme për të përmirësuar procesin e monitorimit dhe dokumentimit të orëve shtesë të punës, në përputhje me politikat dhe rregulloret e vendosura në organizatën tonë.

NjAB rekomandon, që:

Implementimi i një sistemi të qartë dhe të përshtatshëm për autorizimin dhe dokumentimin e orëve shtesë të punës. Ky sistem duhet të jetë i përshtatshëm me politikat dhe rregulloret e vendosura dhe të sigurojë një proces transparent dhe të besueshëm për pagesat e orëve shtesë të punës.

Çështja 5.

Nga puna në teren vërehet se as RTK-TV as në Radio nuk është publikuar orarin e punës në hyrjen kryesore.

Kriteri :

Ne baze te ligjit te punës nr. 03/L-212 neni 23 paragrafi 9, “Punëdhënësi është i obliguar të shpallë orarin e punës në vend të dukshëm”.

Gjendja/Kushti :

Nga ekzaminimet fizike të objekteve të RTK-së dhe Radios, është vërejtur se në hyrjen kryesore të dy objekteve nuk është vendosur orari i punës në hapësirat e dukshme, ashtu siç kërkohet nga aktet ligjore në fuqi.

Shkaku :

Mungesa e informimit dhe kujdesi jo i duhur nga personat relevant në raport me obligimet që rrjedhin nga rregullativa ligjore ka çuar deri te leshimi teknik.

Ndikimi :

Mosinformimi i palëve të treta lidhur me orarin e punës të stafit të RTK-së do të ndikojë në ankesa dhe paqartësi të ndryshme.

Konkluzion:

RTK-TV dhe Radioja duhet të respektojnë ligjin e punës dhe të shpallin orarin e punës në vend të dukshëm. Mungesa e publikimit të orarit të punës në hyrjet kryesore të objekteve të tyre është shkelje e këtij ligji dhe mund të sjellë pasojat ligjore dhe administrative për to. Mosinformimi dhe mungesa e kujdesit nga personat e përgjegjshëm në lidhje me këtë çështje mund të shkaktojë ankesa dhe paqartësi në mes të stafit dhe të palëve të treta. Është e rëndësishme që të ndërmerren hapat e nevojshëm për të korrigjuar këtë situatë dhe për të siguruar respektimin e të gjitha detyrimeve ligjore për orarin e punës.

NjAB rekomandon, që:

Rekomandohet që Administrata e RTK-së të publikojë orarin e punës në hapësirat e dukshme.

4. Rekomandimet

- 4.1 Rekomandohet Menaxhmenti të bëjë vlersimin e nevojave reale për rrekrutim të brendshëm apo te jashtëm i cili do ti mbulonte rrjedhën e aktiviteteve të punës normale jasht oreve shtesë.
- 4.2 Rekomandohet Menaxhmenti që ti mer masat e nevojshme lidhur me rregullimin e çështjeve të orëve shtesë përmes ngritjes së sistemeve të kontrollit të mbrendshëm në mënyre që të mos përseriten dukurit e njëjta.
- 4.3 Rekomandohet Menaxhmenti që ti udhëzojë personat përgjegjës për eliminimin e defektit të modulit të qasjes së sistemit të hyrjeve dhe daljeve, përmes rriparimit apo furnizimit me nje sistem të qasjes së kontrollit.
- 4.4 Implementimi i një sistemi të qartë dhe të përshtatshëm për autorizimin dhe dokumentimin e orëve shtesë të punës. Ky sistem duhet të jetë i përshtatshëm me politikat dhe rregulloret e vendosura dhe të sigurojë
- 4.5 Rekomandohet Administrata e RTK-së që të publikojë orarin e punës në hapësirat e dukshme.
- 4.6 Rekomandohet Menaxhmenti që Master Room-it të jetë cdoher i mbuluar me dy persona me ndryshime të natës sepse prania e dyfishtë në pozicionet kyçe, veçanërisht gjatë orëve të natës, jep siguri që të gjitha protokollat e sigurisë të respektohen dhe të zbatohen në mënyrë të saktë. **Ky rekomandim bazohet në disa arsye kyçe:** *Prania e dy personave rrit nivelin e sigurisë dhe parandalon rreziqet e mundshme që mund të ndodhin gjatë natës. Mbikëqyrja e dyfishtë siguron që operacionet të kryhen pa ndërprerje dhe me një nivel më të lartë precizioni. Dy persona mund të ndihmojnë njëri-tjetrin në rast të ndonjë avarie teknike ose ndonjë problemi të papritur, duke minimizuar kështu kohën e reagimit dhe zgjidhjes së problemeve. Ndërrimet e natës janë shpesh më sfiduese dhe mund të shkaktojnë lodhje dhe stres të shtuar. Prania e një kolegu ndihmon në ndarjen e përgjegjësiave dhe mbajtjen e moralit të lartë.*
- 4.7 Rekomandohet Menaxhmenti, që të lejojë pagesën e orëve shtesë për punonjësit, brenda kornizave të lejuara ligjore. Ky rekomandim synon të rrisë produktivitetin dhe mirëqenien e punonjësve, duke siguruar që RTK-ja të funksionojë në mënyrë efikase dhe brenda kornizave ligjore. **Ky rekomandim bazohet në disa arsye kyçe :** *Pagesa e orëve shtesë duhet të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke respektuar të gjitha normat dhe rregulloret e punës. Kjo masë siguron që RTK-ja të veprojë brenda kornizave ligjore dhe të shmangë çdo shkelje të mundshme të ligjit. Pagesa e drejtë dhe e duhur për orët shtesë rrit motivimin dhe përkushtimin e punonjësve. Kjo krijon një mjedis pune të drejtë dhe të balancuar, duke e bërë RTK-në më atraktive për punonjësit aktualë dhe të ardhshëm. Punonjësit që janë të gatshëm të punojnë orë shtesë mund të kontribuojnë në mbulimin e mungesave të papritura dhe në përballimin e rritjes së ngarkesës së punës.*

Konsiderojmë dhe shpresojmë se rekomandimet e dala nga ky proces i auditimit do të mirëprehen nga menaxhmenti dhe nëpunësit përgjegjës, dhe si të tilla të implementohen nga të gjithë akterët përgjegjës që janë të përfshirë në këto procese, e gjithë kjo me qëllim të ngritjes së efikasitetit operacional, dhe një disiplinë më e madhe në këto procese dhe në respektimin e të gjitha procedurave dhe legjislacionit në fuqi.

5. ANEKSI I-TË GJETURAT E RAPORTIT TË AUDITIMIT DHE KOMENTET E TË AUDITUARIT

Nr.	Të gjeturat	Klasifikimi i të gjeturave	Komentet e Menaxhmentit	Përgjigjet e NjAB-it
1	Gjatë testimit të mostrave, është konstatuar se ka tejkalime të orëve shtesë mbi 32 orë, të cilat nuk janë në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Njëkohësisht, është konstatuar edhe dukuria e bartjes së orëve nga muaji aktual në muajin vijues.	E rëndësisë së lartë.		
2	Nga ekzaminimet e bëra të mostrave, vërehet se në një rast është zhvilluar një dukuri e vijueshmërisë së orëve shtesë përmes dy dokumente (dosjet e punës jashtë orarit), me nënshkrime ndryshme dhe mospërputhje të orëve në dosjen e punës jashtë orarit me sistemin e vijueshmërisë.,	E rëndësisë së lartë.		
3	Marrë parasysh ekzaminimin e mostrave, vërehet se sistemi i hyrjeve dhe daljeve kohë pas kohe nuk bënë evidentimin real të kalkulimit dhe kohës se hyrjeve/daljeve.	E rëndësisë mesme		

4	Mungesa e autorizimeve dhe dokumentaciont të mjaftueshëm mbështetës për pagesat e orëve shtesë të punëtorëve.	E rëndësisë mesme		
5	Nga puna në teren vërehet se as RTK-TV as në Radio nuk është publikuar orarin e punës në hyrjen kryesore.	E rëndësisë së ulët.		

6. ANEKS II- PLANI I VEPRIMIT TË MENAXHMENTIT

Nr.	Rekomandimet	Veprimi i Menaxhmentit	Data e planifikuar për përfundim	Personi përgjegjës
1	Rekomandohet Menaxhmenti të bëjë vlersimin e nevojave reale për rrekrutim të brendshëm apo të jashtëm i cili do të mbulonte rrjedhën e aktiviteteve të punës normale jashtë oreve shtesë.			
2	Nga ekzaminimet e bëra të mostrave, vërehet se në një rast është zhvilluar një dukuri e vijueshmërisë së orëve shtesë përmes dy dokumente (dosjet e punës jashtë orarit), me nënshkrime ndryshme dhe mospërputhje të orëve në dosjen e punës jashtë orarit me sistemin e vijueshmërisë.,			
3	Marrë parasysh ekzaminimin e mostrave, vërehet se sistemi i hyrjeve dhe daljeve kohë pas kohe nuk bënë evidentimin real të kalkulimit dhe kohës së hyrjeve/daljeve.			
4	Mungesa e autorizimeve dhe dokumentacionit të mjaftueshëm mbështetës për pagesat e orëve shtesë të punëtorëve.			
5	Nga puna në teren vërehet se as RTK-TV as në Radio nuk është publikuar orari e punës në hyrjen kryesore.			